



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 janar 2013
Nr. ref.: RK366/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI103/11

Parashtruesi

Gani Morina

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjyimit të Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP.
Nr. 90/10, të 8 prillit 2011**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Gani Morina, avokat nga komuna e Klinës.

Vendimi i kontestuar

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Pejë, AP. Nr. 90/10, i 8 prillit 2011, që i është dorëzuar parashtruesit më 25 prill 2011.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kësaj kërkesë është ankesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me ekzekutimin e gabueshëm të urdhrit për bastisje në shtëpinë e tij, më 17 prill 2007, ku ai është arrestuar dhe i janë vënë prangat, traumat e shkaktuara atij dhe gruas së tij me rastin e ndërhyrjes në shtëpinë e tij dhe cenimi i privatësisë.
4. Përveç kësaj, parashtruesi i kërkesës kërkon që Gjykata Kushtetuese mos ta bëjë të ditur identitetin e tij.

Baza juridike

5. Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës; në nenet 46, 47, 48 dhe 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji); dhe në rregullin 56 (2) të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

6. Më 25 korrik 2011, parashtruesi dorëzoi kërkesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 17 gusht 2011, Kryetari e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Iliriana Islami.
8. Më 22 shtator dhe tetor 2011, Gjykata kërkoi informata nga Prokurori Publik i Kosovës. Gjykata mori përgjigje nga Prokurori Publik më 11 nëntor 2011.
9. Më 14 tetor 2011, Gjykata pranoi dokumentacionin shtesë nga parashtruesi i kërkesës, me një shkresë të 26 korrikut 2011.
10. Më 8 dhjetor 2011, më tej, Gjykata kërkoi nga parashtruesi informatë përkitazi me kërkesën. Më 23 dhjetor 2011, Gjykata mori nga parashtruesi i kërkesës një përgjigje të datës 15 dhjetor 2011.
11. Më 26 nëntor 2012, Kryetari, me vendimin (Nr. GJR. KI103/11) e caktoi gjyqtarin Robert Carolan Gjyqtar raportues, pasi mandati i gjyqtarës Gjyljeta Mushkolaj, si gjyqtare e Gjykatës, kishte skaduar. Të njëjtën datë, Kryetari, me vendimin (Nr. KSH. KI103/11), caktoi Kolegjin e ri shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Almiro Rodrigues dhe Ivan Čukalović, pasi mandati i Gjyqtarës Iliriana Islami si gjyqtare e Gjykatës kishte skaduar.
12. Më 17 janar 2013, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe i paraqiti Gjykatës rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve, siç dëshmohet nga dokumentet e ofruara nga parashtruesi

13. Më 16 prill 2007, është lëshuar një urdhër për bastisje nga një gjyqtar ndërkombëtar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, me të cilin autorizohet bastisja në tri lokale të ndryshme që kishte të bënte me hetimet për tregti me drogë. Njëri nga objektet pretendohet të ketë qenë në pronësi të S. S. dhe të H. S., një shtëpi trekatëshe në rrugën "Bajram Curri", në Klinë. Koha, brenda së cilës do të duhej të kryhej bastisja, ishte ndërmjet orës 06:00 dhe 22:00.
14. Ky urdhër ishte ekzekutuar më 17 prill 2007, nga disa policë në Klinë. Raporti i policisë, i përgatitur më 2 maj 2007, tregonte se, sipas informatave në dispozicion të policisë, shtëpia në rrugën "Bajram Curri" kishte dy hyrje, të ndara në anën e përparme. Dyshohet se dy të dyshuarit S. S. dhe H. S. kanë jetuar atje dhe, nëse hyrja në anën e prapme, ku jetonin dy njerëz të moshuar, nuk kishte lidhje me hyrjen e parë, pjesa e prapme nuk duhej të bastisej. Bastisja filloi në orën 05:50, në një shtëpi pa numër. Përpiluesi i raportit të policisë theksoi se të dy hyrjet lidheshin me një hyrje të përbashkët, që nënkuptonte se mund të lëvizeshin nga hyrja e parë në hyrjen e dytë. Parashtruesi i kërkesës, Gani Morina, avokat, ishte arrestuar aty, i ishin vënë prangat për 2-3 minuta dhe pastaj policët ia kishin hequr prangat.
15. Atje, gjithashtu, ishte edhe një femër, gruaja e parashtruesit, tani e ndjerë. Një police i ishte caktuar asaj dhe asaj nuk i ishin vënë prangat. Parashtruesit i ishin vënë prangat për 2-3 minuta. Urdhri për bastisje i ishte lexuar atij në gjuhën angleze. Gjatë bastisjes, u kontaktua komandanti fushor, i cili konfirmoi se bastisja po kryhej në vendin e duhur. Bastisja vazhdoi dhe përfundimisht u krye në orën 07:06.
16. Më 20 prill 2007, parashtruesi i kërkesës ushtroi ankesë në Prokurorinë e Qarkut në Prizren përkitazi me zbatimin e urdhrit për bastisje, të lëshuar nga Gjykata e Qarkut në Prizren, të datës 16 prill 2007. Megjithatë, ai nuk mori asnjë përgjigje.
17. Më 21 prill 2007, parashtruesi iu drejtua Prokurorisë Komunale në Pejë, duke ngritur akuza në bazë të nenit 166 (1) dhe (3) (vepra penale e cenimit të paprekshmërisë së banesave); në bazë të nenit 167 (vepra penale e kontrollimit të kundërligjshëm); dhe në bazë të nenit 304 (1) dhe (2) (vepra penale e moslajmërimit të veprës penale apo moslajmërimit të kryerësve të veprës penale) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPK). Parashtruesi i ngriti këto akuza, sepse ai pretendonte se F. H., R. F., S. H. dhe D. V. kishin bërë shkelje të dispozitave të nenit 240 (5), të nenit 242 (1), (2), (3) dhe (4), si dhe të nenit 245 (5) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: KPPPK).
18. Më 11 qershor 2007, Prokurori Publik Komunal në Pejë i dëgjo dëshmitarët e bastisjes së kontestuar. Ai erdhi në përfundim se kishte hapësirë për procedurë dhe për përgjegjësi të atyre që e kryen bastisjen. Këtij konkluzioni iu dha shenja e protokollit PPN. nr. 64/02, më 16 korrik 2007.
19. Më 24 gusht 2007, parashtruesi i shkroi një letër Prokurorit Publik Komunal në Pejë dhe u ankua për reduktimin e akuzës. Megjithatë, ai nuk mori asnjë përgjigje.
20. Më 15 nëntor 2007, Prokurori Publik Komunal në Pejë i prezantoi akuzat e propozuara me një urdhër ndëshkimor PP. nr. 1853/2007 kundër të pandehurve R. F., S. H. dhe D. V., por jo kundër F. H., i cili ishte personi kryesor, përgjegjës për lëshimin e urdhrit për bastisje, dhe as kundër E. I., i cili, përveç se ishte anëtar i ekipit të bastisjes, ishte dëgjuar vetëm në cilësi të dëshmitarit. Akuzat kundër R. F., S. H. dhe D. V. u reduktuan në veprën penale të kontrollimit të kundërligjshëm nga neni 167 i KPPK-së.

21. Më 22 nëntor 2007, parashtruesi i shkroi Prokurorit Publik Komunal, duke kërkuar ndryshimin dhe zgjerimin e akuzave të propozuara për të përfshirë bastisjen e përsëritur, për të cilën parashtruesi pretendon se është kryer pa praninë e dëshmitarëve dhe pa dijen e pronarit. Parashtruesi pretendon se kjo ishte shkelje e dispozitave të nenit 243 (7) të KPPPK-së. Parashtruesi nuk mori përgjigje ndaj kësaj parashtruese.
22. Më 14 dhjetor 2007, Gjykata Komunale në Klinë nxori aktgjykimin P. nr. 162/2007 dhe konstatoi se R. F., S. H. dhe D. V. ishin fajtorë për kryerjen e veprës penale të kontrollimit të kundërligjshëm, nga neni 167 (1) në lidhje me nenin 23 të KPPK-së, dhe dënoi secilin veç e veç me gjobë në shumën 250 euro dhe me shpenzimet procedurale.
23. Gjykata Komunale theksoi në arsyetimin e saj se e kishte marrë vendimin bazuar në provat e bashkangjitura propozimit për lëshimin e urdhrit, siç janë: akuzat penale të ngritura nga parashtruesi, urdhri për bastisje i 16 prillit 2007, raporti i bastisjes, artikulli që parashtruesi e kishte botuar në të përditshmen "Epoka e re", raportet e mjekut për bashkëshorten e parashtruesit dhe dokumentet e tjera në dosjen e lëndës.
24. Më 10 janar 2008, R. F., S. H. dhe D. V. ushtruan ankesë ndaj Vendimit P. nr. 162/07. Ata pretenduan se urdhri ndëshkimor është lëshuar bazuar në provat e gabuara. Ata kërkuan të refuzohet propozimi i Prokurorit për lëshimin e urdhrit dhe Gjykata Komunale të caktojë një shqyrtim kryesor për rastin.
25. Më 18 shkurt 2010, pas nxjerrjes së provave në fjalën e tij përfundimtare, Prokurori Publik në Pejë i tërhoqi akuzat e propozuara kundër R. F., S. H. dhe D. V. për shkak të mungesës së dëshmitarëve. Megjithatë, parashtruesi e vazhdoi rastin si një paditës subsidiar.
26. Më 22 shkurt 2010, Gjykata Komunale në Klinë, me Aktgjykimin P. nr. 162/07, liroi R. F., S. H. dhe D. V. nga akuzat e propozuara.
27. Gjykata Komunale, bazuar në provat e vërtetuara nga shqyrtimi kryesor dhe bazuar në dëshmitë e dëshmitarëve, në urdhrin për bastisje dhe në dëgjimin e R. F., S. H. dhe D.V., erdhi në përfundim se në sjelljen e R. F., S. H. dhe D. V. nuk kishte as elemente, e as tipare, të veprës penale të kontrollimit të kundërligjshëm. Prandaj, Gjykata Komunale liroi R. F., S. H. dhe D. V. nga akuzat e propozuara, pasi edhe Prokurori Publik i Pejës, në fjalën e tij përfundimtare, u tërhoq nga ndjekja penale e R. F., S. H. dhe D. V., për shkak të mungesës së provave.
28. Më 25 maj 2010, parashtruesi ushtroi ankesë ndaj Aktgjykimit P. nr. 162/07. Parashtruesi pretendon se në aktgjykim kishte: shkelje substanciale të dispozitave të procedurës penale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje e interpretim të gabuar të së drejtës materiale.
29. Më 8 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Pejë nxori Aktgjykimin Ap. nr. 90/10, me të cilin e vërtetoi Vendimin e Gjykatës Komunale në Klinë, P. nr. 162/07.
30. Më 6 maj 2011, parashtruesi parashtrroi kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës.
31. Më 12 maj 2011, Prokurori i Shtetit i Kosovës e refuzoi kërkesën e parashtruesit. Ai theksoi se, pas shqyrtimit të detajuar të propozimit të parashtruesit, nuk u gjet asnjë arsye e bazuar nga neni 451 dhe nga neni 452 i KPPPK-së për paraqitjen e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

32. Parashtruesi i kërkesës pretendon se është shkelur neni 24 [Barazia para Ligjit]; neni 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]; neni 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave]; dhe neni 55.5 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], i Kushtetutës. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon shkeljen e nenit 1 – Detyrimi për të Respektuar të Drejtat e Njeriut, dhe të nenit 8 – E Drejta për Respektimin e Jetës Private dhe Familjare të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa).
33. Parashtruesi i kërkesës, ndër të tjera, mëton
- që urdhri për bastisje ka qenë në gjuhën të cilën ai nuk e ka kuptuar,
 - që nuk ka përmbajtur as emrin e tij e as të ndonjë anëtari të familjes,
 - që raporti i policisë thekson se shtëpia ka qenë dykatëshe dhe jo trekatëshe,
 - që shtëpia e tij e ka pasur numrin 13 në pjesën e jashtme,
 - që nuk është gjetur drogë e as bunker në oborrin e tij,
 - që bastisja është përsëritur pas orës 09:00 me qentë e trajnuar, pa prani të dëshmitarëve apo të pronarit dhe për këtë nuk ekziston asnjë raport i përgatitur.
34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se shumë prej dispozitave të KPPK-së, të KPPPK-së, të Ligjit për Policinë dhe të Ligjit për Prokurorin e Shtetit, ishin shkelur në kohën e bastisjes dhe gjatë procedurave vijuese gjyqësore.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

35. Në mënyrë që të mund të gjykojë për kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet së pari të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka plotësuar kërkesat e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuar më tej me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
36. Sa i përket kërkesës së parashtruesit, Gjykata i referohet rregullit 36 (3) (h), i cili thotë:
- “Po ashtu një kërkesë mund të konsiderohet si e papranueshme edhe në rastet vijuese kur:*
- h) kërkesa nuk është ratione temporis në pajtim me Kushtetutën”.*
37. Për të përcaktuar juridiksionin kohor të Gjykatës, është qenësore të identifikohet në secilin rast konkret koha e saktë e shkeljes së pretenduar. Duke vepruar ashtu, Gjykata duhet të marrë parasysh faktet për të cilat ankohet parashtruesi dhe shtrirjen e të drejtës kushtetuese që pretendohet se është cenuar (*Shih, mutatis mutandis, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Aktgjykimi i Dhomës në rastin Blečić kundër Kroacisë, Kërkesa nr. 59532/0, e 8 marsit 2006, paragrafi 82*).
38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës ankohet ndaj zbatimit të gabueshëm të urdhrin për bastisje të gabuar në banesën e tij, më 17 prill 2007, nga Policia e Kosovës.
39. Kjo do të thotë se shkelja e pretenduar e të drejtave të parashtruesit të kërkesës, të garantuara me Kushtetutë, ka ndodhur para 15 qershorit 2008, që është data e hyrjes në fuqi të Kushtetutës dhe nga e cila datë Gjykata ka juridiksion kohor.

40. Gjykata ngjashëm ka vendosur në rastin KI100/10, Aktvendim për papranueshmëri, parashtruesi i kërkesës Eduard Thaqi (gjithashtu i njohur si Sokol Thaqi) – Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimit të Policisë së Kosovës, Nr. 398-SHPK-2002, të 22 tetorit 2002.
41. Për më tepër, Gjykata refuzon kërkesën e parashtruesit për moszbulimin e identitetit të tij, në bazë të asaj se ai nuk e ka arsyetuar miratimin e asaj kërkesë.
42. Rezulton që kërkesa e parashtruesit nuk është *ratione temporis* në pajtim me dispozitat e Kushtetutës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 20 të Ligjit; dhe në përputhje me rregullin 36 (3) (h) të Rregullores së punës, më 17 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'iu komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani